



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

## RELACION PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE

Në zbatim ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe VKB nr. 152 datë 07.12.2023 “Për miratimin e kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe të buxhetit vjetor 2025 Bashkia Korçë”, është detyrim ligjor që ti paraqesim Këshillit të Bashkisë përgatitjen e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave.

Ky raport kalon në disa procese :

### Baza ligjore

1. Ligjin nr 9632, datë 30.1.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.
2. Ligjin nr 9920, datë 26.05.2008 " Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
3. Ligjin nr 68/2017 "Për Financat e vetëqeverisjes vendore"
4. Ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
5. Ligjin nr 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar
6. Në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr 153, datë 07.12.2023 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2024"
7. Ligje dhe akte nënligjore të tjera.

### Politikat e hartimit të raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme

Raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme është hartuar bazuar në politikat fiskale ekzistuese, në ecurinë e realizimit të të ardhurave për vitet e mëparshme si dhe në vlerësimet mbi zhvillimet e mundshme ekonomike, me supozimin që politikat fiskale do të mbeten të pandryshuara për periudhën 3 vjeçare, si dhe bazuar në:

- Garantimin e qëndrueshmërisë financiare dhe efikasitetit në menaxhimin e financave të Bashkisë;
- Planifikim afatmesëm duke garantuar një instrument efikas të integritetit të objektivave politike në procesin buxhetor;
- Rritjen e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave në kufijtë e kapacitetit të bazës së taksueshme;
- Forcimin e administratës tatimore vendore;
- Përmirësimin e kushteve të biznesit dhe thjeshtimin e procedurave tatimore dhe lehtësitë fiskale;
- Përditësim dhe plotësim të bazës së të dhënave.
- Përfshirjen qytetare si hallkë e rëndësishme në vendimmarrje;
- Forcimi i kapaciteteve dhe rritja e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave debitore;

### Parashikimi i të ardhurave

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë Korçë mbështetet në politikat fiskale të përcaktuara në Paketën Fiskale të Bashkisë Korçë të miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr 153 datë 07.12.2023 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penaltetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2024" e cila përcakton llojet e taksave dhe tarifave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga ana e Bashkisë, për vendosjen e taksave dhe tarifave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre si dhe aktorët përgjegjës për mbledhjen e tyre.

Në mënyrë të hollësishme përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse dhe tarife, përcakton qartë administrimin e tyre duke filluar me mënyrën e përlllogaritjes, personat përgjegjës të pagimit dhe të mbledhjes të taksës apo tarifës.

Në këtë parashikim afatmesëm për vitet 2025-2027 synohet shpërndarja në mënyrë më të drejtë e barrës fiskale, duke ulur ngarkesën për grupe dhe kategori të caktuara. Përcaktimi real i kapaciteteve të burimeve të të ardhurave shërben për të projektuar sa më drejt potencialet zhvilluese afatmesme. Kjo na mundëson hapa të sigurtë e të qëndrueshëm për hartimin e një parashikimi real, i cili do të garantojë zgjerimin dhe rritjen e efikasitetit të përdorimit të të ardhurave vendore.

### **Metodat e parashikimit të nivelit të të ardhurave në parashikimin afatmesëm:**

- a. Trendi i realizimit të të ardhurave në vitet e fundit.
- b. Zgjerimi i bazës së kapaciteteve fiskale bazuar në politikat vendore të miratuara.
- c. Parashikimi i ecurisë së zgjerimit të bazës dhe kapaciteteve fiskale.

Parashikimi ekspozon rritje të transparencës të burimeve të të ardhurave vendore dhe përmirësim të performancës së kapaciteteve administrative. Niveli i të ardhurave vendore, për periudhën afatmesme 2025-2027, është mbështetur në realizimin e taksave dhe tarifave për periudhën 2022-2023, në politikën fiskale (paketa fiskale) dhe në buxhetin e miratuar për vitin 2024, duke reflektuar të gjitha ndryshimet në legjislacionin aktual në fuqi.

Nga parashikimi i kryer, efektet në rritjen e të ardhurave vendore, për të tre vitet e ardhshme janë parashikuar me rritje në total për vitin 2027 prej 29,277 mijë lekë kundrejt planit të vitit 2024, mesatarisht 9,759 mijë lekë në vit. Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga tarifave vendore dhe të ardhurat e tjera të cilat janë planifikuar me një rritje mesatare prej **1 %** nga viti në vit.

Për të qënë sa më afër realitetit është mbajtur parasysh edhe realizimi faktik i të ardhurave në dy vitet e fundit 2022-2023, detyrimet debitore të krijuara ndër vite, për të cilat në momentin e planifikimit përlllogaritjet vetëm periudha 18 muaj nga faturimi si dhe trendi i zgjerimit të bazës së taksueshme.

Për vitin 2025 janë parashikuar të ardhurat me 1% më shumë se plani i vitit 2024, në vitin 2026 janë parashikuar në 2 % më të larta krahasuar me vitin 2024 dhe për vitin 2027 janë parashikuar me 2 % më lart se në vitin 2024.

E parë në prespektivë në vitin 2027 janë parashikuar të ardhurat vendore në rritje me 29,277 mijë lekë krahasimisht me vitin 2024.

### **Në këtë parashikim janë marrë parasysh:**

**1. Lehtësimi me 20% të vlerës së totalit të tarifave vendore subjektet të cilët kanë mbi 20 persona të punësuar gjatë vitit ushtrimor.**

**2. Përgjysmimi i tarifave vendore për subjektet të cilët kanë mbi 50 persona të punësuar gjatë vitit ushtrimor.**


3. Lehtësimi me 20% të vlerës së totalit të tarifave vendore subjektet të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre me në fushën e institucioneve arsimore private si dhe ato subjekte që do të ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e arsimit privat plotësues ose jo plotësues, organizimit të trajnimeve dhe kualifikimeve në fusha të ndryshme profesionale.
4. Përgjysmimi i tarifave vendore për të gjitha OJF-të, të cilat objekt kryesor të veprimtarisë së tyre kanë aktivitetin sportiv.
5. Përjashtimi nga pagesa e tarifave lokale subjektet të cilat kanë mbi 100 persona të punësuar gjatë vitit ushtrimor.
7. Përjashtimi nga pagesa e taksës së ndërtesës familjet që përbëhen vetëm nga pensionistë
8. Përjashtimi nga pagesa e tarifave lokale familjet që përbëhen nga një pensionist dhe familjet që kryefamiljari i të cilave përfiton ndihmë ekonomike
9. Përjashtimi nga pagesa e tarifave vendore të gjitha familjet jo efektive të cilat pas verifikimeve të përsëritura nga administrata e lagjeve për njësinë administrative Korçë dhe nga njësitë respektive për njësitë e tjera administrative nuk gjenden në banesë dhe nuk banojnë në adresën e deklaruar.
10. Përjashtimi nga pagesa e tarifave të gjithë familjet kryefamiljari e të cilave përfiton statusin e verbërisë.
11. Përjashtimi nga pagesa e tarifave të gjithë familjet kryefamiljari e të cilave përfiton statusin e para-tetra plegjisë.
12. Përjashtimi nga pagesa e tarifave për vitin 2024 të gjitha subjektet të cilat do të zhvillojnë për herë të parë aktivitet dhe regjistrohen nga studentë të diplomuar në universitete brenda dhe jashtë vendit gjatë vitit 2022 dhe 2023.
13. Përjashtimi nga pagesa e tarifave për vitin 2024 të gjithë subjektet që do të regjistrojnë dhe ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në fushën e artizanatit.
14. Përjashtimi nga pagesa e tarifave për vitin 2024 të gjithë investitorët e huaj që do të hapin dhe zhvillojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në Bashkinë e Korçës.
15. Përjashtimi nga pagesa e tarifave për vitin 2024 të gjithë subjektet që do të regjistrojnë dhe ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në fushën e ICT (teknologji e informacionit), aktivitetin e tyre në fushën e institucioneve arsimore private si dhe ato subjekte që do të ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e arsimit privat plotësues ose jo-plotësues, organizimit të trajnimeve dhe kualifikimeve në fusha të ndryshme profesionale.
16. Përjashtimi nga pagesa e tarifave për vitin 2024 të gjithë fermerët që janë regjistruar me NIPT
17. Përjashtimi nga pagesa e tarifave për vitin 2024 të gjithë organizatat jofitimprurëse që do të regjistrojnë dhe ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në Bashkinë e Korçës.

**Struktura e të ardhurave për vitin buxhetor aktual dhe parashikimin për periudhën 2025 - 2027.**

në 000 lekë

Emërtimi i të Ardhurave	Planifikim 2024	Parashikim 2025	Parashikim 2026	Parashikim 2027
Të ardhura nga taksat	752,663	757,390	762,164	766,985
Të ardhura nga tarifat	423,442	427,676	431,953	436,273
Të ardhura të tjera	70,108	70,809	71,517	72,232
<b>Totali</b>	<b>1,246,213</b>	<b>1,255,875</b>	<b>1,265,634</b>	<b>1,275,490</b>


Nëpërmjet grafikut të mëposhtëm po ilustrjmë peshën që zënë taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera kundrejt totalit të të ardhurave të veta të parashikuara për vitin 2024



Struktura e burimit të të ardhurave vendore në vitet e fundit ka krijuar një stabilitet pothuajse të qëndrueshëm ndikuar nga politikat fiskale të ndërmara ndër vite dhe pothuajse është e pandryshueshme në rritje me nivelin e të ardhurave pasi rritjet janë propocionale në të njëjtin nivel.

- Nga analiza e strukturës së burimeve vendore arrihet në përfundim se të ardhurat nga taksat vendore zënë një peshë të konsiderueshme dhe përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave vendore në **60.4 %** të totalit.

Paraqitja grafike:



Kategoritë e taksave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave janë:

- ✓ Taksë mbi pasuritë e paluajtëshme (ndërtesë, truall, tokë bujqësore) e cila zë rreth **23.2 %** të planit në total :
  - 1) Taksë ndërtesë zë **16.6 %** të planit
  - 2) Taksë mbi truallin zë **2 %** të planit
  - 3) Taksë mbi tokën bujqësore zë **4.6 %** të planit
- ✓ Taksë e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe legalizimet të cilat zënë rreth **25.4 %** të planit në total.
- Struktura e burimit të të ardhurave vendore nga tarifat vendore të parashikuara zënë **34 %** të totalit.

Paraqitja grafike :



Kategoritë e tarifave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave janë:

✓ Tarifa e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave publike të cilat zënë rreth **25.3 %** të planit në total:


- 1) Tarifa e pastrimit zë **16.3 %** të planit
- 2) Tarifa e ndriçimit zë **4.6 %** të planit
- 3) Tarifa e gjelbërimit zë **3.1 %** të planit
- 4) Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike zë **1.4 %** të planit

❖ Tarifa për zënien e hapësirës publike, tarifa e parkimit dhe tarifa vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sistemit kullues të cilat zënë rreth **6.3 %** të planit në total:

- 1) Tarifa për zënien e hapësirës publike zë **2.2 %** të planit
- 2) Tarifa e parkimit zë **1.8 %** të planit
- 3) Tarifa vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sistemit kullues zë **2.3 %** të planit.

• Struktura e burimit të të ardhurave vendore nga të ardhurat e tjera të parashikuara zënë **5.6 %** të totalit.

Paraqitja grafike :



Kategoritë e taksave të ndara që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave janë:

❖ Të ardhurat nga taksat e ndara (taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve, tatim shitje pasuri e paluajtëshme, tatim mbi të ardhurat personale) të cilat zënë rreth **10 %** të planit në total:

- 1) Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve zë **4.4 %** të planit
- 2) Tatim shitje pasuri e paluajtëshme **2 %** të planit
- 3) Tatim mbi të ardhurat personale **3.6 %** të planit

Bashkëngjitur këtij relacioni po ju vëmë në dispozicion tabelën me parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2025-2027.

**DREJTOR I DREJTORISË  
TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**

**Soniel Prifti**

**DREJTORE E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME  
JURIDIKE DHE TË MENAXHIMIT  
TË BURIMEVE NJERËZORE**

**Anxhela (Dishnica) Qeramixhi**

**DREJTORE E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME  
FINANCËS, BUXHETIT DHE M.F.K**

**Valbona Ziko**

**KRYETARI I BASHKISË**

**Sotiraq Filo**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KORÇË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**P / V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2024

**“PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE”**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe M.F.K, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe V.K.B nr. 152 datë 07.12.2023 “Për miratimin e kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe të buxhetit vjetor 2025 Bashkia Korçë”.

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI**

1. Të miratojë vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave sipas tabelës nr. 1 bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë dhe Institucionet e Vartësisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Eva NAÇI**

Miratuar me \_\_\_\_\_vota

Vota Pro \_\_\_\_\_

Vota Kundër \_\_\_\_\_

Vota Abstenim \_\_\_\_\_

**K R Y E T A R**

**Ana VERUSHI**